

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“KLEDONI” Sh.p.k.**

Sot, më date **26.01.2021**, une i nenshkruari:

-**Nexhat Hasani** lindur ne Sadovine e Cerkezve me 03.07.1960 ,shtetas Kosovar, rezident ne Lushnje , identifikuar me karten e identitetit me Nr.**1012445241**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**KLEDONI**” **Sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “**KLEDONI**” **Sh.p.k**

**Neni 2**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:- Fier, Lagja “Karbonare e poshtme”, rruga nacionale Fier-Lushnje, pranë “Doni Fruits” SH.P.K , Bashkia Lushnje.

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: *kledonishpk@yahoo.com*  
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë 10 vjet dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

**Neni 4**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

- Investitor dhe sipërmarres ne ndertim dhe hoteleri ,etj.
- Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

**Neni 5**

**Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqindmije) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

**1.** Ortaku themelues **Nexhat Hasani**: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund të bëhet vetëm pasi Asambleja e ortakëve me shumicë të ka dekretuar këtë dhe për më tepër të gjithë ortakët janë të detyruar që ta repektojnë dhe të kontribuojnë në para ose në natyrë në bazë të vendimit të shumicës së asamblese

#### **Neni 7:**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen përmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes; (me të drejtën e parablerjes nga ana e ortakëve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjorisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitakit themeltar janë ligjorisht të transferueshme me rrugë trashgimnie.

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimarrës**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve, përjashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen në statutin e shoqërisë.

#### **Neni 9**

##### **Administrimi**



Aministrator i shoqërisë emerohet Z. **Nexhat Hasani** lindur ne Sadovine e Cerkezve me 03.07.1960 ,shtetas Kosovar, rezident ne Lushnje , identifikuar me karten e identitetit me Nr.**1012445241** ,madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe **5** vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

#### **Neni 10**

##### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cialt është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

#### **Neni 11**

##### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë jane te percaktuara ne statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i Ndryshuar.

#### **Neni 12**

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale.

#### **ORTAKU I VETEM I SHOQERISE**

**Nexhat Hasani**

